FLETORJA ZYRTARE
E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

www.qbz.gov.al

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2021 – Numri: 151

Tiranë – E enjte, 30 shtator 2021

PËRMBAJTJA

		Faqe
Dekret i Presidentit nr. 13246, datë 27.9.2021	Për dhënie të shtetësisë shqiptare.....	14291
Akt normativ i Këshillit të Ministrave nr. 30, datë 27.9.2021	Për miratimin e disa ndryshimeve të nënshkruara në marrëveshjen për prodhimin dhe furnizimin nga dhe ndërmjet *Pfizer Export B.V.* dhe Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale të Shqipërisë, ministrit të Shtetit për Rindërtimin dhe Institutit të Shëndetit Publik, miratuar me aktin normativ nr. 3, datë 18.1.2021, të Këshillit të Ministrave.....	14291
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 539, datë 17.9.2021	Për lirim nga detyra.....	14292
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 544, datë 29.9.2021	Për një shtesë në vendimin nr. 536, datë 1.5.2008, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Durrës, të qarkut të Durrësit", të ndryshuar.....	14292
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 545, datë 29.9.2021	Për kryerjen e pagesës së dozave të vaksinave dhe të pagesave respektive, që rrjedhin nga akti normativ nr. 30, datë 27.9.2021, i Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e disa ndryshimeve të nënshkruara në marrëveshjen për prodhimin dhe furnizimin nga dhe ndërmjet *Pfizer Export B.V.* dhe Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale të Shqipërisë, ministrit të Shtetit për Rindërtimin dhe Institutit të Shëndetit Publik, miratuar me aktin normativ nr. 3, datë 18.1.2021".....	14292
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 547, datë 29.9.2021	Për dhënie ndihme financiare familjes së nënkomisarit Saimir Bilal Hoxha, ish-punonjës policie, i vrarë në krye të detyrës.....	14293
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 548, datë 29.9.2021	Për miratimin e rregullave dhe të procedurave të detajuara për trajtimin financiar të familjarëve të punonjësve të Gardës së Republikës së Shqipërisë, që humbin jetën në krye apo për shkak të detyrës.....	14293

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 549, datë 29.9.2021	Për miratimin e llojeve të armatimit, të lëndëve neuroparalizuese, të mjeteve dhe të pajisjeve të tjera kufizuese, për përdorimin e forcës nga Garda e Republikës së Shqipërisë.....	14295
Urdhër i ministrit të Drejtësisë nr. 547, datë 23.9.2021	Për delegimin dhe disa rregulla të përfaqësimit ligjor të Ministrisë së Drejtësisë.....	14297

DEKRET
Nr. 13246, datë 27.9.2021

PËR DHËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, pika "c" dhe të nenit 93, të Kushtetutës, si dhe të neneve 8, 20 e 23, pika 1, të ligjit nr. 113/2020, "Për shtetësinë", me propozimin e Ministrisë së Brendshme,

DEKRETOJ:

Neni 1

U jepet shtetësia shqiptare, me kërkesë të tyre, këtyre personave:

1. Hatun Ahmet Yilmaz (Çubuk)
2. Vlora Sejdi Zeqiri
3. Gjergj Bejta Sabedini
4. Bajrush Ismajl Hashani
5. Agron Riza Bicaj
6. Arben Murat Bytyqi
7. Naser Rasim Bytyqi
8. Alper Yasin Salih Yilmaz
9. Avdije Ahmet Hoti Elezi (Hoti)
10. Stefano Carlo Romano
11. Makbule Murat Kurtuluş (Tuğlar)
12. Sanie Ahmed Muhamed (Hamdi)
13. Asma Siraj Abdulsattar Shaikh
14. Arbër Luan Shabani
15. Elmi Isak Krasniqi
16. Cihan Namik Kemal Güngör
17. Halil Buğra Halil Çelikler
18. Nerxhivane Miftar Krasniqi

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Ilir Meta

AKT NORMATIV
Nr. 30, datë 27.9.2021

PËR MIRATIMIN E DISA NDRYSHIMEVE TË NËNSHKRUARA NË MARRËVESHJEN PËR PRODHIMIN DHE FURNIZIMIN NGA DHE NDËRMJET *PFIZER EXPORT B.V.* DHE MINISTRISË SË SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE TË SHQIPËRISË, MINISTRIT TË SHTETIT PËR RINDËRTIMIN DHE INSTITUTIT TË SHËNDETIT PUBLIK, MIRATUAR ME AKTIN NORMATIV NR. 3, DATË 18.1.2021, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE

Në mbështetje të nenit 101 të Kushtetutës, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministrit të Shtetit për Rindërtimin dhe Programin e Reformave dhe ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Neni 1
Miratimi i disa ndryshimeve

Miratimin e disa ndryshimeve të nënshkruara në marrëveshjen për prodhimin dhe furnizimin, nga dhe ndërmjet *Pfizer Export B.V.* dhe Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale të Shqipërisë, ministrit të Shtetit për Rindërtimin dhe Institutit të Shëndetit Publik, miratuar me aktin normativ nr. 3, datë 18.1.2021, të Këshillit të Ministrave, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij akti normativ.

Neni 2
Hyrja në fuqi

Ky akt normativ hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM
Nr. 539, datë 17.9.2021

PËR LIRIM NGA DETYRA

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 6, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave", me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Znj. Bora Muzhaqi, zëvendësministër i Arsimit, Sportit dhe Rinisë, lirohet nga kjo detyrë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM
Nr. 544, datë 29.9.2021

PËR NJË SHTESË NË VENDIMIN NR. 536, DATË 1.5.2008, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN, NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM TË BASHKISË DURRËS, TË QARKUT TË DURRËSIT", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3 e 5, të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001, "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore", të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në listën e inventarit të miratuar me vendimin nr. 536, datë 1.5.2008, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, shtohet dhe transferohet në pronësi të Bashkisë Durrës, për Njësinë Administrative Durrës, një pjesë e pasurisë me numër 147/24, me sipërfaqe prej 400 000 m^2, me vendndodhje në zonën kadastrale 8517, sipas formularit dhe planit të rilevimit bashkëlidhur këtij vendimi, me qëllim për t'u përdorur në funksion të procesit të rindërtimit në Njësinë Administrative Durrës për të prekurit nga tërmeti i datës 26 nëntor 2019.

2. Ngarkohen Bashkia Durrës dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM
Nr. 545, datë 29.9.2021

PËR KRYERJEN E PAGESËS SË DOZAVE TË VAKSINAVE DHE TË PAGESAVE RESPEKTIVE, QË RRJEDHIN NGA AKTI NORMATIV NR. 30, DATË 27.9.2021, I KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR MIRATIMIN E DISA NDRYSHIMEVE TË NËNSHKRUARA NË MARRËVESHJEN PËR PRODHIMIN DHE FURNIZIMIN NGA DHE NDËRMJET *PFIZER EXPORT B.V.* DHE MINISTRISË SË SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE TË SHQIPËRISË, MINISTRIT TË SHTETIT PËR RINDËRTIMIN DHE INSTITUTIT TË SHËNDETIT PUBLIK, MIRATUAR ME AKTIN NORMATIV NR. 3, DATË 18.1.2021"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 45, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, të nenit 14, të ligjit nr. 137/2020, "Për buxhetin e vitit 2021", të ndryshuar, dhe të aktit normativ nr. 30, datë 27.9.2021, të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e disa ndryshimeve të nënshkruara në marrëveshjen për prodhimin dhe furnizimin nga dhe ndërmjet *Pfizer Export B.V.* dhe Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale të Shqipërisë, ministrit të Shtetit për Rindërtimin dhe Institutit të Shëndetit Publik, miratuar me aktin normativ nr. 3, datë 18.1.2021", me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministrit të Shtetit për Rindërtimin dhe Programin e Reformave dhe të

ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kryerjen, nga Instituti i Shëndetit Publik, të pagesave të përcaktuara në aktin normativ nr. 30, datë 27.9.2021, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e disa ndryshimeve të nënshkruara në marrëveshjen për prodhimin dhe furnizimin nga dhe ndërmjet *Pfizer Export B.V*. dhe Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale të Shqipërisë, ministrit të Shtetit për Rindërtimin dhe Institutit të Shëndetit Publik, miratuar me aktin normativ nr. 3, datë 18.1.2021", në vlerën 6 009,120 (gjashtë milionë e nëntë mijë e njëqind e njëzet) USD, të konvertuara sipas kursit zyrtar të këmbimit të ditën e pagesës.

2. Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, në buxhetin e saj të miratuar për vitin 2021, në llogarinë ekonomike 6050000 (produkti 91305AH) të programit "Shërbime të shëndetit publik" (07450), i shtohet ekuivalenti në lekë i shumës prej 6 009,120 (gjashtë milionë e nëntë mijë e njëqind e njëzet) USD, për kryerjen e pagesës së dozave të vaksinës nga kompania *Pfizer Export B.V*.

3. Fondi, sipas pikës 2, të këtij vendimi, të përballohet nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit, miratuar për vitin 2021.

4. Ngarkohen zëvendëskryeministri dhe ministri i Shtetit për Rindërtimin dhe Programin e Reformave, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Instituti i Shëndetit Publik për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM
Nr. 547, datë 29.9.2021

PËR DHËNIE NDIHME FINANCIARE FAMILJES SË NËNKOMISARIT SAIMIR BILAL HOXHA, ISH-PUNONJËS POLICIE, I VRARË NË KRYE TË DETYRËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 137/2020, "Për buxhetin e vitit 2021", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Dhënien e ndihmës financiare, prej 5 000 000 (pesë milionë) lekësh, familjes së Nënkomisarit Saimir Bilal Hoxha, ish-punonjës policie në Komisariatin e Policisë Lezhë, në Drejtorinë Vendore të Policisë Lezhë, i vrarë në krye të detyrës.

2. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit.

3. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM
Nr. 548, datë 29.9.2021

PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE DHE TË PROCEDURAVE TË DETAJUARA PËR TRAJTIMIN FINANCIAR TË FAMILJARËVE TË PUNONJËSVE TË GARDËS SË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, QË HUMBIN JETËN NË KRYE APO PËR SHKAK TË DETYRËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 54, të ligjit nr. 33/2021, "Për Gardën e Republikës së Shqipërisë", me propozimin e ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Objekti i këtij vendimi është përcaktimi i rregullave dhe i procedurave të detajuara për trajtimin financiar të familjarëve të punonjësve të Gardës së Republikës së Shqipërisë, që humbin jetën në krye ose për shkak të detyrës.

2. Trajtimi financiar që fëmijët e punonjësve të Gardës së Republikës së Shqipërisë përfitojnë, në bazë të rregullave dhe të procedurave të përcaktuara në këtë vendim, të zbatohet pa krijuar mbivendosje me ndonjë përfitim të mundshëm financiar sipas ligjeve të tjera. Në këtë rast, ata kanë të drejtë të zgjedhin trajtimin financiar më të favorshëm, sipas rregullave dhe procedurave të parashikuara në atë ligj.

II. NDIHMA E MENJËHERSHME FINANCIARE

1. Pjesëtarët e familjes, që bashkëjetonin me punonjësin e Gardës së Republikës së Shqipërisë në çastin e humbjes së jetës, në krye apo për shkak të detyrës, përfitojnë ndihmë të menjëhershme financiare për çdo person, në masën e një page, referuar pagës mujore të muajit të fundit të shërbimit.

2. Përfitimi i ndihmës së menjëhershme nuk duhet të jetë më shumë se 10 (dhjetë) paga në total.

3. Pjesëtarë të familjes, që bashkëjetonin me punonjësin e Gardës së Republikës së Shqipërisë në çastin e humbjes së jetës, janë:

a) fëmijët;

b) bashkëshorti/bashkëshortja;

c) prindërit;

ç) personat në kujdestari.

4. Për t'u trajtuar me ndihmë të menjëhershme financiare, pjesëtarët e familjes duhet të paraqesin pranë Gardës së Republikës së Shqipërisë dokumentacionin e mëposhtëm:

a) procesverbalin e referimit nga strukturat përkatëse të rrethanave të ngjarjes, në të cilën ka humbur jetën punonjësi;

b) certifikatën familjare;

c) certifikatën e vdekjes së punonjësit;

ç) dokumentin e identitetit të personit që kërkon përfitimin.

5. Masa e këtij shpërblimi miratohet me urdhër të ministrit përgjegjës për rendin e sigurinë publike.

6. Dhënia e ndihmës së menjëhershme financiare përballohet nga buxheti i ministrisë përgjegjëse për rendin dhe sigurinë publike për programin "Garda e Republikës".

III. PENSIONI SUPLEMENTAR FAMILJAR

1. Pjesëtarët e familjes, që bashkëjetonin me punonjësin e Gardës së Republikës së Shqipërisë, në çastin e humbjes së jetës në krye apo për shkak të detyrës, përfitojnë pension suplementar familjar në masën 100 (njëqind) % të pagës mujore të muajit të fundit kalendarik të shërbimit, pavarësisht nga periudha e sigurimit.

2. Përfitimet jepen në vlerën 100 (njëqind) % të pagës, sa herë që paga sipas së cilës është llogaritur ky përfitim ndryshon.

3. Pagesa e pensionit suplementar përballohet nga buxheti i ministrisë përgjegjëse për rendin e sigurinë publike për programin "Garda e Republikës".

IV. TRAJTIMI ME BURSË PËR SHKOLLIM

1. Studentët që rezultojnë fëmijë të punonjësve të Gardës së Republikës së Shqipërisë, që kanë humbur jetën në krye apo për shkak të detyrës, të cilët janë regjistruar në programe studimi në institucionet publike të arsimit të lartë, trajtohen sipas kuadrit ligjor në fuqi.

2. Fëmijët e punonjësve të Gardës së Republikës së Shqipërisë, që kanë humbur jetën në krye apo për shkak të detyrës, paraqesin te Garda e Republikës së Shqipërisë dokumentacionin që provon statusin e tyre si studentë.

3. Garda e Republikës, për çdo vit akademik, i paraqet ministrisë përgjegjëse për arsimin listën e studentëve që rezultojnë fëmijë të punonjësve të Gardës së Republikës së Shqipërisë, që kanë fituar të drejtën e ndjekjes së studimeve të larta, për trajtimin e tyre me bursë.

V. TRAJTIMI ME BANESË FALAS

1. Enti Kombëtar i Banesave trajton me banesë falas bashkëshorten/in dhe fëmijët e punonjësit të Gardës së Republikës, që ka humbur jetën në krye apo për shkak të detyrës, kur janë të pastrehë, sipas listës së miratuar nga ministri përgjegjës për rendin e sigurinë publike, e cila shoqërohet me dokumentacionin e mëposhtëm:

a) certifikatë familjare;

b) vërtetim nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës për pjesëtarët e familjes përfituese, nëse figurojnë apo jo me banesë në pronësi apo në proces.

VI. TRAJTIMI FINANCIAR PËR ÇDO PËRVJETOR VDEKJEJE

1. Familjarëve të punonjësit të Gardës së Republikës, që ka humbur jetën në krye apo për shkak të detyrës, u jepet ndihmë financiare në masën e 1 (një) page mujore për çdo përvjetor vdekjeje.

2. Për t'u trajtuar me ndihmë financiare, për çdo përvjetor vdekjeje, pjesëtarët e familjes duhet të paraqesin pranë Gradës së Republikës, dokumentacionin e mëposhtëm:

a) kërkesë për përfitimin e ndihmës financiare;

b) certifikatë familjare;

c) dokument të identitetit të personit që kërkon përfitimin.

3. Masa e kësaj page është e barabartë me pagën bazë mujore të gradës "Inspektor".

4. Dhënia e ndihmës financiare miratohet nga drejtori i Përgjithshëm i Gardës së Republikës dhe përballohet nga buxheti i ministrisë përgjegjëse për rendin e sigurisë publike për programin "Garda e Republikës".

VII. ORGANIZIMI I CEREMONISË MORTORE

1. Ceremonia mortore për punonjësit e Gardës së Republikës, që kanë humbur jetën në krye apo për shkak të detyrës, organizohet nga drejtuesi i strukturës së Gardës së Republikës së Shqipërisë.

2. Pagesa e shpenzimeve miratohet nga drejtori i Përgjithshëm i Gardës së Republikës së Shqipërisë, sipas dokumentacionit të mëposhtëm:

a) kërkesë për miratim të shpenzimeve të drejtuesit të strukturës së Gardës së Republikës së Shqipërisë;

b) fatura tatimore të shpenzimeve për organizimin e ceremonisë mortore.

3. Shpenzimet e ceremonisë mortore përballohen nga buxheti i Gardës së Republikës së Shqipërisë.

VIII. PUNËSIMI

1. Garda e Republikës së Shqipërisë, brenda limitit organik, trajton me prioritet aplikimin ose kërkesën për punësim të fëmijëve të punonjësve të Gardës së Republikës së Shqipërisë, që kanë humbur jetën në krye ose për shkak të detyrës, në përputhje me arsimimin, përvojën dhe kriteret e tjera të nevojshme për vendin e punës.

IX. DISPOZITA TË FUNDIT

1. Ngarkohen Ministria e Brendshme, Garda e Republikës së Shqipërisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Ministria e Arsimit dhe Sportit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM
Nr. 549, datë 29.9.2021

PËR MIRATIMIN E LLOJEVE TË ARMATIMIT, TË LËNDËVE NEUROPARALIZUESE, TË MJETEVE DHE TË PAJISJEVE TË TJERA KUFIZUESE, PËR PËRDORIMIN E FORCËS NGA GARDA E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 62, të ligjit nr. 33/2021, "Për Gardën e Republikës së Shqipërisë", me propozimin e ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e llojeve të armatimit, të lëndëve neuroparalizuese (lëndë kimike për kontrollin e turmave), të mjeteve dhe të pajisjeve të tjera kufizuese, për përdorimin e forcës nga Garda e Republikës së Shqipërisë, sipas tekstit të lidhjes nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Deri në rinovimin e plotë të armatimit, strukturat e Gardës së Republikës së Shqipërisë përdorin armatimin e pajisjet aktuale.

3. Vendimi nr. 830, datë 1.12.2003, i Këshillit të Ministrave, "Për pajisjen e punonjësve të Gardës së Republikës së Shqipërisë me armatim dhe mjete teknike të posaçme", i ndryshuar, shfuqizohet.

4. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe Garda e Republikës së Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

LIDHJA NR. 1
LLOJET E ARMATIMIT, LËNDËT NEUROPARALIZUESE (LËNDË KIMIKE PËR KONTROLLIN E TURMAVE), MJETET DHE PAJISJET E TJERA KUFIZUESE, PËR PËRDORIMIN E FORCËS NGA GARDA E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Punonjësit dhe strukturat e Gardës së Republikës së Shqipërisë pajisen me armatim, lëndë neuroparalizuese (lëndë kimike për kontrollin e turmave), mjete dhe pajisje të tjera kufizuese për përdorimin e forcës gjatë kryerjes së detyrave të ngarkuara, sipas funksionit organik të çdo punonjësi të Gardës së Republikës së Shqipërisë, sipas kësaj lidhjeje.

Llojet e armatimit, të municioneve dhe të pajisjeve janë, si më poshtë vijon:

1. Armatim

1.1 Armë zjarri për përdorim individual:

a) armë të shkurtra zjarri (pistoletë) kalibër 9 x 19 mm.

1.2 Armë zjarri për përdorim kolektiv:

a) armë të gjata zjarri automatike kalibër 5.56 x 45 mm deri 9 x 19 mm.

1.3 Armë speciale:

a) armë ceremoniale;

b) armë të drejtuara me energji (ADE);

c) armë me elektroshok;

ç) armë e ftohtë;

d) armë për përdorim/hedhje të municioneve dhe mjeteve të ndryshme (*shotgun*/lëshues);

dh) armë pneumatike;

e) armë e gjatë zjarri me përpikëri të lartë (snajper), gjysmautomatike, kalibër 5.56 x 45 mm deri 12.7 x 99 mm;

ë) armë për sinjalizim;

f) armë për sinjalizim të lehtë akustik;

g) armë të tjera për përdorim, të cilat do të njihen si të tilla nga aktet ndërkombëtare, të ratifikuara me ligj në Republikën e Shqipërisë;

gj) armë zjarri me zhurmëzbutës të montuar;

h) armë zjarri sportive;

i) mjete optike të armëve të zjarrit për shikim dhe shënjim;

j) pjesë kryesore të armëve të zjarrit;

k) pajisje e posaçme për armët e zjarrit.

2. Municion:

a) granata akustike, tymuese dhe verbuese për përdorim policor, të cilat nuk sjellin dëme të pakthyeshme të shëndetit dhe janë në përputhje me legjislacionin në fuqi kundër torturës dhe trajtimeve a dënimeve të tjera mizore, çnjerëzore ose poshtëruese;

b) municione për armët e shkurtra e të gjata të zjarrit, sipas kalibrave përkatës, me të gjitha llojet e cilësisë së veprimit;

c) municione që hidhen me *shotgun* me saçme: gome, metalike, sintetike;

ç) municione me lëndë kimike (irrituese / ngacmuese) në formë pluhuri ose lëngu për përdorim policor, që hidhen me *shotgun*/lëshues, me granatë dore, pajisje hedhëse, *spray* (individual/ kolektiv) ose tubat, për mbrojtjen, menaxhimin e kontrollin e turmave, të cilat nuk sjellin dëme të pakthyeshme të shëndetit dhe janë në përputhje me legjislacionin në fuqi kundër torturës dhe trajtimeve a dënimeve të tjera mizore, çnjerëzore ose poshtëruese, me kufi ngacmues 0.05–0.1 mg/m^3, kufiri toksik 1–5 mg/m^3, indeksi i avullimit 40.000–75000 $mg/min/m^3$;

3. Pajisje kufizuese për përdorimin e forcës

3.1 Pajisje kufizuese për përdorimin e forcës (për përdorim individual):

a) çantë me pllaka antiplumb e hapshme për mbulim VIP-i[1];

b) jelek antiplumb;

c) kaskë balistike antiplumb;

ç) kaskë plastike;

d) këmishë jelek balistik;

dh) kostum për mbrojtje nga mjetet e forta;

e) mburojë balistike individuale, mburojë plastike për mjetet e forta;

ë) mjete mbrojtëse gjatë qitjes (syze balistike, kufje mbrojtëse për qitje);

f) mjete mbrojtëse nga lëndët kimike e bakteriologjike;

g) pajisje dhe mjete komunikimi;

gj) pajisje dhe mjete ndriçuese;

h) pajisje dhe mjete optike;

i) pajisje dhe mjete orientimi (GPS, busulla);

j) pranga metalike dhe plastike;

k) shkop gome/metalik;

l) veshje antieksploziv.

[1] Personalitete të larta shtetërore.

3.2. Pajisje kufizuese për përdorimin e forcës (për përdorim kolektiv):

a) çantë valixhe antieksploziv, pasqyrë për kontrollin e mjeteve, pasqyrë teleskopike me kamera me rreze infra;

b) detektor kërkimi (metal, eksploziv, lëndë radioaktive/kimike), porta detektorë, skaner për kontrollin e sendeve, aparat eksploziv kërkues;

c) komplet universal xhenier (pincë, thikë, kaçavidë);

ç) pajisje dhe aparate për përcaktimin e pozicionit gjeografik dhe të distancave;

d) pajisje kontrolluese e testuese të qitjes;

dh) pajisje të lehta degazimi, dezinfektimi, si dhe lëndë degazuese e dezinfektuese;

e) pajisje dhe mjete kufizuese (barriera metalike, bllokues rrugësh, zinxhir kolektiv);

ë) pajisje dhe mjete optike (pajisje për shikim mbrapa pengesave; kamera termale, sondë infra të kuqe; dylbi dite dhe nate);

f) pajisje dhe mjete për operacione në lartësi (shkallë portative operacionale; pajisje alpinistike kolektive);

g) pajisje të tjera për përdorim policor, të cilat do të njihen si të tilla nga aktet ndërkombëtare, të ratifikuara me ligj në Republikën e Shqipërisë;

gj) pajisje vëzhgimi dhe zbulimi (dite dhe nate);

h) pajisje për zbulim kimik, biologjik, radioaktiv dhe ndotësit e mjedisit;

i) qen eksplozivkërkues;

j) robotë antieksplozivë dhe të ndryshëm;

k) sisteme dron/antidron dhe pajisje për bllokimin e valëve telefonike;

l) simulatorë trajnimi dhe aftësimi për çdo armë zjarri.

4. Sisteme sigurie, vëzhgimi dhe komunikimi:

a) pajisje dhe mjete komunikimi;

b) pajisje për sisteme e rrjete kompjuterike;

c) sisteme GPS (sisteme të përcaktimit të vendndodhjes);

ç) sisteme të vëzhgimit me kamera, sisteme të akses-kontrollit të personelit, sisteme të kontrollit të automjeteve, sisteme të kontrollit të perimetrit të objekteve, sisteme të sinjalizimit të rrezikut ndaj zjarrit e ujit.

URDHËR
Nr. 547, datë 23.9.2021

PËR DELEGIMIN DHE DISA RREGULLA TË PËRFAQËSIMIT LIGJOR TË MINISTRISË SË DREJTËSISË

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës; të nenit 28, të ligjit nr. 44, datë 30.4.2015, "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë",

URDHËROJ:

1. Autorizimet për përfaqësimin ligjor të Ministrisë së Drejtësisë në proceset gjyqësore, kur thirret si palë në një gjykim, lëshohen nga Sekretari i Përgjithshëm, në emër të personit/personave që do të përfaqësojnë ministrinë.

2. Autorizimet për përfaqësimin ligjor të Ministrisë së Drejtësisë, kur thirret si palë në gjykim, në proceset gjyqësore në të cilat objekti i padisë ka lidhje me institucionin e varësisë, lëshohen në emër të personit/personave që do të përfaqësojnë ministrinë nga drejtuesi i institucionit të varësisë, sipas vendit ku është ngritur kërkesë-padia.

3. Modeli i autorizimit për përfaqësimin në proceset gjyqësore të jetë sipas lidhjes nr. 1, bashkëlidhur këtij urdhri.

4. Përfaqësimi për çdo proces gjyqësor bëhet nga juristë të Sektorit të Përfaqësimit Gjyqësor, pranë Drejtorisë së Miradministrimit të Burimeve Njerëzore, Aseteve dhe Shërbimeve, specialistë të fushës për të cilën është ngritur kërkesëpadia, si dhe përfaqësues nga institucionet e varësisë së Ministrisë së Drejtësisë, nëpërmjet autorizimit përkatës.

5. Përfaqësimi ligjor i Ministrisë së Drejtësisë në proceset gjyqësore, sipas këtij urdhri, i jep të drejtë përfaqësuesve të autorizuar të kryejnë çdo veprim procedural, të parashikuar nga legjislacioni në fuqi, në kuadër të përfaqësimit në shkallën përkatëse të gjykimit.

6. Përfaqësuesit e caktuar të ndjekin me korrektësi seancat gjyqësore, për sa i takon pjesëmarrjes së tyre, e veçanërisht kontributit provues, paraqitjes së kërkesave, prapësimeve, pretendimeve, ankimeve, rekurseve, si dhe dokumenteve të tjera, që do të ndihmonin

mbrojtjen e interesave të institucionit të Ministrisë së Drejtësisë.

7. Në përfundim të proceseve gjyqësore, në çdo shkallë të gjyqësorit, brenda një afati 5-ditor nga shpallja/njoftimi i vendimit, të paraqitet informacion i detajuar, i shoqëruar (aty ky është e mundur) me vendimet përkatëse në Ministrinë e Drejtësisë.

8. Ngarkohen të gjitha institucionet e varësisë së Ministrisë së Drejtësisë të caktojnë një person përgjegjës që do të jetë pikë kontakti për të shkëmbyer çdo informacion të nevojshëm, si dhe njoftim për ecurinë e ndjekjen e proceseve gjyqësore, me Sektorin e Përfaqësimit Gjyqësor, pranë Drejtorisë së Miradministrimit të Burimeve Njerëzore, Aseteve dhe Shërbimeve, në Ministrinë e Drejtësisë.

9. Ngarkohet Sektori i Redaktimit Gjuhësor, Shërbimeve dhe Arkiv-Protokollit për vënien në dispozicion të dokumenteve të nevojshme, me qëllim paraqitjen e tyre konfom ligjit, në cilësinë e provave materiale për proceset gjyqësore.

10. Ngarkohen Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Miradministrimit të Burimeve Njerëzore, Aseteve dhe Shërbimeve, Sektori i Përfaqësimit Gjyqësor, Sektori i Arkiv-Protokollit dhe institucionet e varësisë së Ministrisë së Drejtësisë për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I DREJTËSISË
Ulsi Manja

(SEKRETARI I PËRGJITHSHËM/INSTITUCIONI I VARËSISË)

Nr. _____ prot. Tiranë, më _____._____.2021

AUTORIZIM PËR PËRFAQËSIMIN NË ÇËSHTJEN GJYQËSORE ME PALË:

Paditës: .....
E paditur: .....
Objekti: .....

Në mbështetje të neneve 64–77 të Kodit Civil; të nenit 96 të Kodit të Procedurës Civile; të nenit 14, të ligjit nr. 49, datë 3.5.2012, "Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", dhe të urdhrit të ministrit të Drejtësisë nr. ……., datë ……, "Për delegim dhe disa rregulla të përfaqësimit ligjor të Ministrisë së Drejtësisë",

VENDOSA:

Autorizimin e ……. dhe ……., për të përfaqësuar Ministrinë e Drejtësisë, së bashku ose veç e veç, në bashkëpunim me Avokaturën e Shtetit, në të gjitha seancat gjyqësore të procesit ……. me nr. ……. akti, pranë Gjykatës …….

Përfaqësuesi ka të drejtë të përgatisë, nënshkruajë e depozitojë të gjitha aktet e nevojshme procedurale para gjykatës, në përputhje me ligjin dhe në interesin e ligjshëm të palës së paditur, Ministrinë e Drejtësisë, të cilën përfaqëson, deri në marrjen e formës së prerë të vendimit.

(SEKRETARI I PËRGJITHSHËM/DREJTUESI I INSTITUCIONIT TË VARËSISË)

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Vulosur elektronikisht nga Qendra e Botimeve Zyrtare
Viti: 2021 - Numri: 151
Datë: 2021/09/30 16:13:47
abd8651a-1b6e-4639-ace6-c6b2641f9604

Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë të një procedure automatike nga një sistem elektronik (Qendra e Botimeve Zyrtare)

	Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2021

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 48 lekë